




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep: Dep: <u>DPKI</u>	Nr Prot: Br Prot: <u>06/1847/20</u>
Nr i faq: Broj stranica Nr. pages: <u>02</u>	Data: Datum: <u>16.09.2020</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 09.09.2020, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-06-1106/20, për zyrtarin e lartë z. Fatmir Dragidella, Kryesues i Departamentit për Shërbime Shëndetësore në Qendren Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë z. Fatmir Dragidella, Kryesues i Departamentit për Shërbime Shëndetësore në Qendren Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës dhe njëkohësisht Kryetar në Organizatën joqeveritare “Shoqata e Parodontologëve të Kosovës”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia kundër Korrupsionit, fillimisht e ka njoftuar zyrtarin e lartë me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari i lartë është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, nuk



mund të ushtroj edhe funksionin e kryetarit në organizatë joqeveritare sepse kjo është e ndaluar me neni 14 (paragrafi 1) të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit, në të cilën thuhet:

1. Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me to.

Ndërsa me nenin 19 të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit parashihen masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave. Dispozitat e nenit në fjalë përcaktojnë se:

1. Në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari sipas rastit dhe rrethanave:

1.1. transferon interesin privat dhe të drejtat në drejtimin e ndërmarrjes sipas përcaktimeve të nenit 15 të këtij ligji; [...];

1.3. jep dorëheqjen nga detyrat, funksionet ose veprimtaritë që janë në konflikt ose të papajtueshme me funksionin e tij publik;

1.4. dorëhiqet nga funksioni publik.

Zyrtari i lartë, është deklaruar se do të ndërmarr veprime për tu larguar nga funksioni i kryetarit në organizatën joqeveritare të cituar më lartë, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, zyrtari i lartë z. Fatmir Dragidella e ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare me nr. (06-1284--1/20), me të cilën dëshmohet se si ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionit si kryetar në Organizatën joqeveritare "Shoqata e Parodontologëve të Kosovës". Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

